



Republika e Kosovës  
Republika Kosova - Republic of Kosovo  
Komisioni Qendror i Zgjedhjeve  
Centralna Izborna Komisija  
Central Election Commission



Në pajtim me autorizimet e dhëna nga neni 64, paragrafi 64.2 të Ligjit nr. 03/L-073 për Zgjedhjet e Përgjithshme në Republikën e Kosovës si dhe duke u bazuar në nenin 2 të Rregullës Zgjedhore nr. 13/2013 për Fushatën e Zgjedhjeve dhe Njoftimin për Ngjarjet Politike, paragrafin 2.2 të Rregullës Zgjedhore Nr. 10/2013 – Raundi i Dytë i Zgjedhjeve për Kryetarë të Komunave, Komisioni Qendror i Zgjedhjeve në mbledhjen e rregullt të mbajtur me datë 23.10.2021, merr këtë:

### VENDIM

#### Për Caktimin e Fushatës Zgjedhore për Raundin e Dytë të Zgjedhjeve për Kryetar të Komunave

- I. Caktohet perioda e fushatës zgjedhore për raundin e dytë të zgjedhjeve për Kryetar të Komunës, e cila do të filloj me 8 nëntor 2021 dhe do të përfundoj me 12 nëntor 2021.
- II. Të gjitha aktivitetet zgjedhore të subjekteve politike dhe kandidatëve të tyre duhet të zhvillohen në përputhshmëri me dispozitat ligjore në fuqi dhe Rregullën Zgjedhore Nr. 13/2013 për Fushatën Zgjedhore dhe Njoftimin për Ngjarjet Politike.
- III. Obligohet Zyra për zbatimin e këtij vendimi.
- IV. Ky vendim hyn në fuqi me datën e nënshkrimit.

Komisioni Qendror i Zgjedhjeve

Kreshnik Radoniqi, Kryesues

